

# Udhëzuesi për Fillimin e Shpejtë

PËRDORIMI I MANUALIT TË MËSUESIT TË SEMINARIT

## Përpara se të Filloni të Jepni Mësim

1. Studioni hyrjen e manualit të mësuesit të seminarit për vitin aktual që të njiheni me disa nga mjetet e përfshira në manual për t'ju ndihmuar.
2. Merrni një udhëzues të ritmit të mësimit për programin tuaj vendor të seminarit nga bashkërenduesi/ja ose administratori/ja i/e programit të SeI-së.
3. Përdoreni këtë udhëzues të ritmit që të përcaktoni mësimin e ardhshëm që do të jepni mësim.

## Vështrim i Përgjithshëm mbi Manualin e Mësuesit të Seminarit

- Ky manual është organizuar për të bashkërenduar çdo javë me materialin e studimit të programit *Eja, Më Ndiq* dhe përfshin pesë mësimet për secilën javë.
- Secili grup prej pesë mësimesh veçohet nga një dokument që jep një vështrim të përgjithshëm të shkurtër për çdo mësim. Ky vështrim i përgjithshëm përfshin
  - qëllimet e mësimit;
  - ide për përgatitjen e nxënësve;
  - ide për mësimet me sende dhe fletushka, figura, materiale filmike apo materiale të tjera të sugjeruara, që mund të kërkojnë njoftim paraprak për t'u përgatitur; dhe
  - sugjerime për mësimdhënien me videokonferencë.

- Çdo javë përfshin të paktën një përvojë mësimore të zotërimit doktrinor.
- Herë pas here përfshihet një mësim “Vlerësoni të Mësuarit Tuaj” për t'i ndihmuar nxënësit të reflektojnë për atë që po mësojnë dhe mënyrën se si po rriten për sa i përket njohurive, qëndrimeve dhe sjelljeve që e thellojnë kthimin në besim dhe i ndihmojnë ata të bëhen më shumë si Ati Qjellor dhe Jezu Krishti.

## Trajnim Shtesë

Së bashku me hyrjen në manualin e mësuesit të seminarit, burimet vijuese janë në dispozicion për trajnim shtesë:

- Mbledhjet e trajnimit me bashkërenduesin/en ose administratorin/en e programit tuaj për të trajtuar pyetjet që keni dhe për të ushtruar aftësitë mësimdhënëse
- Trajnimi për zhvillimin e aftësive të mësuesve
- Trajnimi përvetësojeni pastaj përshtateni programin mësimor të seminarit
- Trajnimi për zotërimin doktrinor
- Trajnimi për vlerësimet

